

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rritet numri i vizitorëve në Kalanë e Lezhës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/rritet-numri-i-vizitoreve-ne-kalane-e-lezhes-i586666
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:24:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 11:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c5a43bdce3dade0faca0f1463786f4ede92987dd853e07bf039723a73da6e45d
TEKSTI	a63e9a5a4b0a23b5dee786e3fdecd20b5dddec63bc1c20c55d9d819e32dbbbe1b
PAMJA	d745cb36da7cb1e5b18de2e7da7d261bb5d34d30df205537b331a6a881b998f3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7a969f4d6f765ba00db72feaf7ae1545255f96feef737fd3e9dbeb72fc26738c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e203f033d074a2d3c42a790e4ddfadf0e6c8e1c0300d49c3347be227adaa7f43
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7a969f4d6f765ba00db72feaf7ae1545255f96feef737fd3e9dbeb72fc26738c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



1 e [Diddy mbetet pa avokat! Firma ligjore kerkon te terhiqet, pretendon se reperi nuk ka paguar prej 6 muajsh](#)[Rritet numri i vizitoreve ne Kalane e Lezhes](#)[Alarm ne Gjermani](#)
fundit

Rritet numri i vizitorëve në Kalanë e Lezhës



17 Shtator 2026, 13:20Kulturë TEMA



Edhe në mes të shtatorit, monumentet e trashëgimisë kulturore në vend vijnë të jenë pjesë e itinerareve të vizitorëve vendas dhe të huaj.

Mes tyre, Kalaja e Lezhës mbetet një nga pikat më të vizituara të qytetit, duke ofruar një kombinim të historisë, arkeologjisë dhe peizazhit.

Në Kalanë e Lezhës, numri i vizitorëve për periudhën nga muaji janar e deri më sot, është 5884 vizitorë. Pjesa më e madhe e tyre vijnë nga Evropa Perëndimore, ku kryesojnë shtetas anglezë, francezë e gjermanë.

Sipas Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, vizitorë të shumtë mbërrijnë çdo ditë në kala, ku gjurmët e periudhave të ndryshme historike ndërthuren me panoramën e qytetit dhe të Adriatikut.

Kalaja ngrihet mbi kodrën e qytetit të Lezhës, në një pozicion strategjik që ka pasur rëndësi të veçantë ndër shekuj. Historia e saj lidhet me periudha të ndryshme, nga antikiteti deri në Mesjetë dhe periudhën osmane.

Zona e kalasë ndodhet mbi Akrolisin e lashtë, qytetin antik që lidhet me zhvillimin e hershëm të Lezhës. Muret dhe gjurmët arkeologjike dëshmojnë për ndryshimet që ka pësuar fortifikimi në periudha të ndryshme. Në hapësirën e kalasë dhe rreth saj ruhen gjurmë të ndërhyrjeve dhe rindërtimeve të ndryshme, duke e bërë monumentin një dëshmi të drejtpërdrejtë të historisë së gjatë të qytetit.

Përtej vlerave historike dhe arkeologjike, Kalaja e Lezhës tërheq vizitorët edhe për panoramën që ofron mbi qytetin, fushën e Zadrimës dhe drejt Adriatikut. Ky kombinim i trashëgimisë dhe peizazhit e kthen vizitën në kala në një përvojë ku historia ndërthuret me natyrën. A.K./TemA



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[41 vepra të piktorit të njohur shqiptar Ibrahim Kodra do të prezantohen së bashku në ekspozitën “Deti dhe Muzika”](#)

11:29 Kulturë

[VIDEO: Nga mitet te dokumentet: koha për ta rilexuar të shkuarën](#)

09:51 Kulturë

Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut/ Kushi: Kujtimi i viktimave është një përgjegjësi morale

09:27 Kulturë

Promovohet novela e Fate Velajt në Pogradec

17:11 Kulturë / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.